



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:239502

Datë: 16.03.2020

Numri i dokumentit: 00900013

**C.nr.1011/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Pergjithshem, si kontestimore e përbëre nga gjyqtari Skender Shala, me procesmbajtësen Muradije Prekazi, ne çështjen juridike te paditësve Dr. Ma, D. T, G. R, Dr. T, B, Sr, G. M, G. V, Z, B, S. A, S. S, V. V, Z. P, V. D, S. K, V. M, O. J, M. L, N. S, J. R, P. T, D. K, S. S, S. R, L. M, D. S, V. Vu, A, V. nga, D. A, M. Z, M. R, nga dhe A. B. nga, të cilet i përfaqëson B. Q. nga, sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditurës, te cilen e perfaqeson, zyrtare e larte ligjore ne Avokaturen Shtetërore te Kosoves ne Prishtine, për pagesen në emër të të ardhurave personale, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor dhe publik te datës 28.02.2020, me dt. 16.03.2020, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve D. M, D. T, Go. R, D. T, B. S, G. M, G. V, V. Z, B. S, A. S, S. V, V. Z. P, V. D, S. K, V. M, O. J, J. R, P. T, D. K, S. S, K. S, S. R, L. M, D. S, V. V, A. V. nga, D. A, M. Z, M. R, nga dhe A. B. nga kundër te paditures Qeveria e Republikës së Kosovës, për pagesën e të ardhurave personale, **E PA BAZUAR.**

**II.** Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditësit në data kryesisht të peraferta kanë parashtruar në gjykatë padi kundër të paditures Qeveria e Kosovës, për pagesën e të ardhurave personale.

Kjo gjykate me aktgjykimin C.nr.656/2015, date 06.10.2017 ka refuzuar padine dhe kerkespadine e paditesve si te pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosoves me aktvendimin C.A.149/18 te dt. 15.08.2019 ka pranuar ankesen e paditesve dhe ka prishur aktgjykimin e Gjykates Themelore ne Mitrovice C.nr.656/15 te dt.06.10.2017 dhe lenden e ka kthyer ne rigjykim.

Meqenëse janë disa lëndë të të njëjtës natyrë dhe të gjithë paditësit i përfaqëson i njëjti person, objekti i kontestit është i njëjtë dhe pala e paditur është e njëjtë, gjykata me propozim te te autorizuarit te paditsve dhe për hirë të ekonomizimit të procedurës ka bërë bashkimin e lëndëve dhe tani pas kthimit te lendeve nga Gjykata e Apelit ne Prishtine, procedura per te gjitha lendet dhe palet paditse udhehiqet nen numrin C.nr. 1011/2019.

Suke vepruar sipas udhezimeve te gjykates se Apelit ne prishtine – Dega ne Mitrovice kjo gjykate me dt. 28.02.2020, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ne te cilen i autorizuari i paditesve ka deklaruar se mbetet ne teresi nga deklaratat e dhena nga seancat e kaluara. Me tutje ka shtuar se e paditura me asnje prove nuk e ka deshmu bazen e pageses se te ardhurave personale te paditesve, ne baze te se ciles kishte per tu thirrur ne mungesen e legjitimitetit aktiv. Nje gje te tille nuk e ka prezantuar as ne senacen e pare e as ne seancat tjera duke u arsytuar se pagesa eshte bere nga fondet tjera, per te cilat paditesit nuk jane ne dijeni se nga cilat mjete dhe prej te cila fonadeve buxheti i Kosovs ia ka paguar te ardhuat personale nga nje (1) Janari i vitit 2012 e deri ne ndalesen e pageses se metutjeshme per peridhen sa kane punuar paditesit tek Administrata e UNMIK-ut. Kete obligim ligjor e ka edhe gjykata anadaj, eshte e domosdoshme qe e paditura ta njoftoi gjykatën se perse i ka paguar paditesit dhe perse e ka ndalur pagesen e metutjeshme. Kerkesat e mija i bazon ne Ligjin e Marrdhenëve te Punes dhe ne Ligjin e Marredhenjeve te Detyrimeve. Sa i perket qeshtjes se paditesve se a e kane pasur cilesine e sherbysve civil apo te puntorve te institucioneve publike deklaroi se punedhenesi - Administrata e UNMIK-ut nuk eshte shtruar se ne qfar cilesie eshte i padituri, a eshte puntor civil a puntor fizike ose ekspert, po ka pas per qellim shtrirjen e administrates , gjegjesisht veteqeverisjes edhe ne pjesen Veriore te Kosoves, pra se per te padituren nuk ka qene me rendesi se a kane punuar ose jo paditesit, mund te konstatohet se e paditura ne asnje dokument nuk e ka deshmuar orarin e punes, kohen e punes, punen ose cilindo veprim te paditesve, por vetem eshte arsyetuar se nuk ka mjete te mjaftueshme ne buxhetin e Kosoves nga Korriku i vitit 2012, ndersa per vazhdimin e raportit kontraktual te marredhenies se punes e ka ceke se i njejti do te vazhdoi deri me 31.12.2012 dhe se i njejti nuk mund te vazhdohet me tutje. Pra, nga nje shkrese e tille e ushtruesit te detyres se shefit te Administrates se UNMIK-ut ne Mitrovice nuk eshte relevante statusi i kontraktuesit ne keto raste i paditesve e as pagesat qe do te behen nepermjet buxhetit te Kosoves, gjegjesisht qe do te behet nepermjet buxhetit te Kosoves si dhe data e skadimit se vlefshmeris se Kontrates se Punes. Mungesa e mjeteve ne momentin e njoftimit te paditesve nga ana e te paditures nuk e liron te padituren qe te ben pagesen per punen e paditsve deri me 31.12.2012, konfom Kontrates mbi Marredhenien e Punes te lidhur ne mes te Administrates se UNMIK-ut ne Mitrovice dhe paditsve.

Me tutje thekson se baza ligjore ne baze te se ciles e paditura eshte e obliguar qe te vazhdoj pagimin e ketyre pagave qendron ne : Urdhereset se UNMIK-ut nr.14/1999, Urdhereset e UNMIK-ut nr. 45/2000, Urdhereset e UNMIK-ut nr. 26/2002, Urdhereset e UNMIK-ut nr.11/2003 dhe Urdhereset se UNMIK-ut nr. 9/2001 e dates 15.05.2001 mbi konstutimin e suazave te veteqeverisjes se perkohshme ne Kosove. Sipas mendimit tim e paditura ka pasur obligim ligjor qe te vazhdoi pagimin e pagave ndaj paditesve, e nuk ka qene qeshtje vullnetare.

Ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se mbes ne teresi prane padise dhe kerkespadise dhe deklarimeve ne seancën e sotme dhe te kaluara dhe se gjykates i propozoj qe ne baze te provave te administruara kerkespadite e paditesve ti miratoj si te bazuara nga se e paditura ka

qene e obliguar qe paditesve t'iu paguaj konform shkreses mbi emerimet nga muaji Korrik perkatesisht Gusht e deri me 31.12.2012.

Shpenzimet e procedures i kerkoj .

Perfaqesuesja e te paditures ne te njejten seance ka deklaruar se mbetet edhe me tutje ne teresi prane te gjitha deklarimeve dhe kundershimeve te bera me shkrim deri me tani ashtu edhe te parashtruara gojarisht ne senacat e mbajtura, duke ekundershtuar edhe me tutje ne tersi si te pa bazuar kerkespadine paditesve, pasi qe dhe me tutje e paditura konsideron se ne kete qeshtje juridike i mungon legjitimiteti real pasiv per te qene pale ne kete procedur. Po ashtu deklaroi se edhe pse nuk pajtohet me vendimin e gjykates se apelit C.nr.149/2018 e dates 15.08.2018, gjykates i propozon qe te vazhdoj proceduren sipas rekomandimeve te dhena. Metutje shtoi se fillimisht e paditura sqaron se e kundershton legjitimitetin real pasiv te te paditures Qeveria e Kosoves e jo legjitimitetin real aktiv te paditsve siq theksoj i autorizuari i paditesve ne deklaraten e tij duke u nisur nga shkresat e lendes posaqrisht kontratat e punes te paditesve te cilat vertetojn sakt raportin kontraktual, ne mes te punedhensesit Adminsitartes se UNMIK-ut te paditsve secilin veq e veq, bazuar ne dispozitat e ligjit te punes detyrimet per pagese i takojn punedhensesit ne kete rast Adminstrates se UNMIK-ut pavarshitet cilat fonde i ka shfrytezuar sipas kompetences se vet per pagesen mujore te paditseve ne cilesin e punemarresve, ndersa me shkrsen e dates 12.12.2012 vertetohet sakt mungesa e legjitimitetit real pasiv te te paditures, per pagesen e paditsve e cila tani eshte objekt kontesti, pasi qe ne kete shkres shefi i Administrates se UNMIK-ut ne Mitrovice, sqaron menyren e shfrytezimit te fondeve te tija per pagesen e paditseve, i falenderon paditsit per punen e kryer si dhe tregon perpjekjet e tija te cilat do ti kete ne te ardhmen per keto pagesa, mirepo ne asnje rresht te kesaj shkrese nuk e detyron Qeverin e Kosves, per pagasat e paditesve per peridhen kontestuese. Paditesit kane pasur te themeluar marredhenien e punee me Adminsitareten e UNMIK-ut, e jo me Qeverin e Kosves, kjo vertetohet nga Kontartat e punes ne shkresat e lendes. Qeveria e Kosoves nga sistemi i pagesave shihet se jane bere disa pagesa nga kodi buxhetor i Komunes se Mitrovices, mirepo per arsyet e pageses si perfaqesuese nga Avokatura shtetore e cila perfaqeson Qeverin e Kosoves, e nuk e perfaqeson [REDACTED] ngase e njejta ka perfaqesuesit e vet te Zyres ligjore nuk kam pergjigje per momentin. Megjithate duke pasu parasysh shtrirjen e Administrimit te Unmikut ne ter Republikën e Kosves, e posaqrisht ne pjesen e [REDACTED] administrataa e UNMIK-ut, ka pasur autoritet te shfrytezoj cilatdo fonde qe ka dashur e kete e ka sqaruar edhe ne shkresen e lendes 12.12.2012, shefi i UNMIK-ut.

Ndersa sa i perket urdhersave ne te cilat u thirre i autorizuari i paditesve si me larte, per momentin nuk kam ndonje pergjigje sepse nuk jam e sigurt per -permbajtjen e ketyre urdhersave ngase ka kaluar nje kohe e gjate. Ne fjalen e saj perfundimtare deklaroi se mbes ne teresi prane deklaratave, kundershimeve dhe pretendimeve te bera ne seancen e sotme dhe seancat e kaluara si dhe te gjitha parashtresave te dorezuara deri me tani ne kete gjykate lidhur me kete ceshtje juridike, andaj duke patur parasysh se paditesit marredhenien e punes e kan themeluar me Administraten e UNMIK-ut zyra ne Mitrovice, e posaqerisht shkresen e dates 12.12.2012, perfaqesuesja e te paditures konsideron se me kete vertetohet edhe mungesa e legjitimitetit real pasiv e te paditures andaj i propozojme gjykates qe kerkespadine e paditesve mbi kete baze ta refuzoj si te pabazuar.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoj.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte dhe te plote te gjendjes se fakteve per aq sa palet ndergjyqjese i parashtruan ato dhe propozuan prova per provimin e tyre , ne kuptim te nenit 7 te LPK-se, ne proceduren e provave ne shqyrtimin kryesor te mbajtur me dt. 28.02.2020, beri

administrimin e provave me leximin e: shkresave mbi emerimet, shkreses se UD-se Shefit te UNMIK-ut drejtuar Shefit te administrates ne Mitrovice e dt. 12.12.2012, pasqyrat e pagave te paguara buxheti I Republikes se Kosoves ne emer te paditesve.

Gjykata pasi qe beri analizimin dhe vleresimin e seciles prove veq e veq e ne lidheshmeri njera me tjetren, qmuarjes me kujdes dhe ndergjegjije , e duke u mbeshtetur me dispoziten e nenit 8 te LPK-se, arriti ne perfundim se ne rastin konkret duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga arsyet si ne vijim:

Nga kontrata - shkresat mbi emërimet vertetohet fakti se paditsit kane themeluar mardhenje pune si punemarres me administraten e UNMIK-ut Zyra ne Mitrovice, si punedhenes, por në asnjë nen apo dispozite të saj nuk përmendet Qeveria e Kosovës, por punëdhënës është UNMIK-ut, madje në pikën c) në faqen e dytë të kësaj shkrese përmendet fare qartë në mënyrë të specifikuar se punëmarrësi nuk duhet të kërkoj, apo të pranon instruksione në lidhje me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë autoritet tjetër përveç nga UNMIK-u, madje edhe nënshkrimi është dhënë nga ana e përfaqësuesit të UNMIK-ut, ndersa ne piken d) ne faqen e tret te shkrese-emerimeve theksohet kjart “ pervec , kur ndryshe specifikohet nen kushte speciale te cekura me posht, ky eshte nje emerim me orar te plote, gjate te cilit nga ju kerkohet te punoni 40 ore ne jave, sipas orarit te punes te percaktuar nga Komuna qe ju puneson”

Nga shkresa e datës 12.12.2012, vertetohet se përfaqësuesi i UNMIK-ut i drejtohet paditësve në mënyrë individuale secilit prej tyre, se kontrata e punës i përfundon me datë: 31.12.2012, me informimin se i njeiti do te beje perpjekje qe pagat e papaguara nga muaji Qershor i vitit 2012 t’iu paguhen, ndërsa më lartë cek se nuk ka fonde – mjete te disponueshme nga Bugjeti i Kosoves per UAM nga Korriku i vitit 2012.

Fakti se e përmend qe nuk ka fonde apo mjete financiare nga Buxheti i Kosoves për pagesën e këtyre punetoreve nuk vërteton obligimin e Qeverise për pagesën por është çështje alternative, sepse prape se prap ne instance te fundit obligimi bie mbi Administraten e UNMIK-un si punedhenes.

Është parim se kontrata është ligj për palët kontraktuese dhe se obligimet që rrjedhin nga kontrata mund ti përmbushin vetëm palët nënshkruese të asaj kontrate e jo ndonjë autoritet tjetër ( Pacta Sund Servada), andaj duke u bazuar ne kete parim palet kontraktuese marrin per obligim te permbushin obligimet e tyre kontraktuese ashtu sic figurojne ne kontrate.

As ne dokrinen juridike por as ne praktiken e gjertanishme gjyqsore nuk eshte i njohur ndonje rast kur kontrata per pune e lidhur ne mes te punedhenesit dhe punetorit – punemarresit te krijoj apo te prodhoi pasoja juridike per personin e trete.

Paditësit gjykatës i kanë dorëzuar një listë të pagave që kanë pranuar nga Qeveria e Kosovës, mirëpo jo edhe ndonjë provë tjetër që vërteton se Qeveria ka marrë për obligim pagesën e tyre.

Nje pjese e pagave se paku ne baze te listave te pagave eshte paguar permes Qeverise, perkatesisht nga buxheti i saj, por kjo ka pasur mundesi te behet permes te nje fondi, e qe sipas vleresimit te kesaj gjykate ka mundur me qene vullnetar, por obligim sipas ligjeve ne fuqi , Ligjit te Punes dhe Ligjit per Sherbyesit Civil nuk ka. Pervec kesaj sipas deklarimeve te perfaqseses se te paditures vihet deri te konstatimi se pagat te cilat iu jane paguar paditesve jane bere nga Kodi buxhetor i [REDACTED] ndersa paditesit nuk kane bere fare kerkese per zgjerimin e padise edhe ndaj [REDACTED] dhe per kete arsye gjykata

nuk ka mundur te zgjerohet ne kete aspekt pa pasur kerkese te paleve ne kontest (parimi i disponibilitetit).

Ne baze te dispozites se nenit 322 te LPK -se, barra e provës bie mbi paditësit, gjë që në rastin konkret me asnjë provë nuk kanë mundur ta bindin Gjykatën se e paditura ka për obligim që të njëjtëve tua paguajë pagat e mbetura, pasi nuk ka nënshkruar askund ndonjë kontratë mbi pranimin e këtij obligimi dhe si rezultat i kësaj e paditura nuk gëzon legjitimitet pasiv për të qenë palë e paditur në këtë procedurë, e ne kete kontekst e paditura nuk ka mare kurrfare obligimi per te permbushur kete pagese te te ardhurave personale paditesve.

Gjykata ne riprocedim te kesaj ceshtjeje me kujdes te veqant i vlersoi pretendimet e te autorizuarit te paditsve por te njejtat nuk mundi ti merr si relavante dhe me ndikim per vendosje ndryshe ne kete ceshtje lendore, per arsye as ne kete procedure nuk i ka ofruar kesaj gjykate asnje provë te re me te cilen do ta binde Gjykatën se e paditura ka për obligim që paditsve tua paguajë pagat e mbetura, pasi qe nuk u provua se e paditura ka nenshkuar ndonjë kontratë apo dokument ne baze te te cilit argumentohet se ka pranuar nje obligim te tille.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e veta te procedures kontesitmore, gjykata e bazoi konrofm nenit 450 te LPK-se.

Nga permbledhja e fakteve, gjendjes se vertetuar faktike dhe arsyet ligjore te cekura me lart, konform nenit 143.1 te LPK -se, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.1011/2019, date 16.03.2020.**

**GJYQTARI**  
Skender Shala

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afat prej 7 ( shtate ) ditësh, nga dita e pranimi, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, e përmes kësaj gjykate.